

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	N.P.T. "EURO SERA" me adresë në Klinë
Nga:	Jetulla Kabashi – Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM i Kërkesën për rishqyrtim të datës: 03/07/2018
Datë:	02/08/2018

E nderuar znj. Arlinda Sejdiya – Drejtoreshë,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të datës: 31/07/2018, të pranuar formë elektronike përmesë e-mail adrese: prokurimi.rahovec@gmail.com, nga OE: N.P.T. "EURO SERA" me adresë në Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi i serave me participim (80 %: 20 %)**, Numri i Prokurimit: **623-18-3101-5-2-1**, Numri i brendshëm: **623-18-018-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Komuna e Rahovecit**.

Kerkesa është REFUZUAR si e pa bazë konform nenit 108/A pika 8.4 të LPP-së.

- Arësytet:

Te lista e kontratave të nënshkruara me O.E. privatë, me Biznese Invidivuale, me persona fizik keni prezantuar në listë se ju keni referenca në vlerë: 520,640.20 Euro, që kjo listë e kontratave të prezantuara nga ana juaj nuk korespondon me referencat të cilat i keni në dosjen tuaj të dorëzuar në Zyrën e Prokurimit.

Në kërkesën tuaj për rishqyrtim keni shkruar se janë shkelur nene:

Neni 7. Paragarfi 1.

Neni 59. Paragarfi 4.

Neni 72.

Komisioni i vlerësimit dhe i rivlerësimit gjatë Ekzaminimit, Krahimit dhe Vlerësimit të dosjes tuaj nuk ka bërë asnjë shkelje të këtire neneve të pretenduara nga ana juaj.

Sqarim: Referencat e prezantuar në dosjen tuaj nga Arta Përquku në listë të kontratave të nënshkruara paraqitet si person fizik ndërsa referencën e ka lëshuar si Biznes Individual të nënshkruar dhe të pavulosur.

Tek lista e kontratave të nënshkruara ju keni thënë se Arta Përquku ka nënshkruar kontratë me juve me datë: 27.08.2017, në vlerë prej: 22,800.00 €.

Referenca e prezantuar nga Arta Përquku është lëshuar me të njejtën datë (27.08.2017) edhe kur është nënshkruar kontrata, ku shkruar se NPT "Eurosera" i keni përfunduar të gjitha furnizimet dhe ndërtimin e serës prej 19 ari, si grand i AZHB – së, brenda ditës që është e pa mundur të përfundohet.

Në tekstin vijues po në të njejtën referenc Arta Përquku thotë se NPT "Eurosera" ka përfunduar me sukses dhe me afat të rregullt ndërtimin e serës prej 50 ari, dhe shkruan se punët janë përfunduar në të njejtën ditë që është nënshkruar kontrata.

Tek transferet bankare Arta Përquku herë si Biznes Individual herë si Person Fizik në llogarin Bankare të NPT "Eurosera" të prezantuara nga ana e tij janë deponuar më shumë mjete financiare

se sa është prezantuar në listën e kontratave të nënshkruara, andaj kjo referencë nuk i përmbush kërkesa minimale të dosjes së tenderit dhe si rrjedhojë ju jeni shpallur si O.E. i papërgjegjshëm.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

-Kundër këtij **vendimi të AK ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Me respekt

Jetulla Kabashi

Shef i Zyres së Prokurimit – Komuna e Rahovecit.
